

UDHËZIM
Nr. 2, datë 21.1.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, “PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Pikat 1 dhe 3 të kreut I/A ndryshojnë si vijon:

“1. Subjekti juridik vendës ose i huaj aplikon nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, duke plotësuar formularin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, brenda datës 15 tetor për vitin akademik pasardhës.

...

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, subjekti ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vetdeklarimin që subjekti, administratori dhe ortakët/ët nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) projekt-statutin e institucionit të arsimit të lartë (në vijim LAL), ku përcaktohen detyrimisht strukturat dhe kërkesat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

c) listën e stafit akademik dhe ndihmësakademik, sipas njësive kryesore/njësie bazë ku do të atashohen;

ç) kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë “Profesor” dhe “Lektor”, kopje të diplomës “Master i shkencave” për kategorinë “Asistent lektor”;

d) aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin e personelit akademik me kohë të plotë, nënshkruar prej tyre me autoritetin drejtues të parashikuar për institucionin e arsimit të lartë;

dh) numrin e studentëve që parashikohet të regjistrohen në programet e studimit në rast hapjeje të LAL-së, i nevojshëm për vlerësimin e standardit mbi raportin personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, parashikuar në VKM-në nr. 418/2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, të ndryshuar;

e) vërtetimin bankar me anë të të cilit subjekti garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përllëgaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit;

ë) mandatë pagesën prej 30% të shumës së tarifës bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të llojit të LAL-së, parashikuar në tabelën 2/a, të vendimit nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin

dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar;

f) kopjen e certifikatës së pronësisë së godinës ose kontrata e qirasë/huapërdorjes me afat jo më pak se 3 (tre) vjet, shoqëruar me kopje të skanuar të certifikatës së pronësisë së qiradbënësit;

g) relacionin mbi infrastrukturën e godinës nga eksperti i licencuar, ku detajohen ambientet minimale të nevojshme për hapjen e LAL-ve, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, që janë si më poshtë:

i. auditorë mësimi;

ii. laboratorë për programin studimit dhe ndjekje praktikash;

iii. ambiente për personelin akademik;

iv. ambiente për personelin administrativ;

v. bibliotekë dhe ambiente për senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj.;

vi. ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës, si: kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

b) Pas pikës 3 të kreut I/A, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1 Subjekti duhet të disponojë edhe dokumentacionin që MAS-i siguron me ndërveprim nga institucionet përgjegjëse shtetërore, që janë:

a) ekstrakti i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ose vendimi i regjistrimit nga gjykata kompetente për subjektin juridik, ku të jetë përfshirë arsimi i lartë në objektin e veprimtarisë së tij;

b) leja higjieno-sanitare dhe akti për mbrojtjen nga zjarri.”.

c) Pika 3 e kreut I/B ndryshon si vijon:

“3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS, institucioni i arsimit të lartë, brenda 15 ditëve, ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për miratimin e riorganizimit të llojit LAL-së;

b) listën e programeve të studimit që do të ofrohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë;

c) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas njësive kryesore dhe njësive bazë, kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë “Profesor” dhe “Lektor”, si dhe kopje të diplomës “Master i shkencave” për kategorinë “Asistent lektor”;

c) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të LAL-së, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM-në nr. 418, datë 10.5.2017, e ndryshuar. Kjo deklaratë shoqërohet me dokumente që vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të mjediseve dhe plotësimin e kritereve infrastrukturore, për një periudhë jo më pak se 3 vjet;

d) mandat pagesën prej 30% të shumës së parashikuar për vlerësimin e jashtëm të llojit të LAL-së, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar”.

ç) Pas pikës 3 të kreut I/B, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1 MAS siguron me ndërveprim, nga institucionet përgjegjëse shtetërore, aktet e hapjes dhe akreditimit të parë/periodik të LAL-së.”

d) Pika 1 e pikës I, të kreut I/D ndryshon si vijon:

“1. Mbyllja e institucionit të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave mbi bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin, mbështetur në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë.

LAL, deri në 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të vitit akademik, ka të drejtë të aplikojë në platformën e-Albania dhe plotëson formularin ku argumentohen shkaqet për mbylljen e LAL-së. Në formular plotësohen deklaratat për:

a) shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe taksave vendore, shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucionet përgjegjëse;

b) masat e marra për përfundimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve të LAL-së dhe për pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve që nuk kanë përfunduar studimet;

c) përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të LAL-së.

Aplikimi duhet të shoqërohet me propozimin e Senatit Akademik dhe miratimin e Bordit të Administrimit për mbylljen e LAL-së.”

dh) Pika 2 e pikës I, të kreut I/D, shfuqizohet.

e) Pikat 4 dhe 5 të kreut II/A ndryshojnë si vijon:

“4. Në rast të miratimit të aplikimit në fazën e parë, LAL-ja brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

Për LAL-të e huaja vendimet e organeve përkatëse të saj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin;

b) vërtetimin bankar me anë të së cilës LAL garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përlogaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit;

c) aktin e akreditimit të LAL-së dhe të programeve të studimit që do të ofrohen, në rastin e LAL-ve të huaja;

d) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas njësisë kryesore/njësisë bazë ku atashohen dhe kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë “Profesor” dhe “Lektor”, kopje të diplomës “Master i shkencave” për kategorinë “Asistent lektor”;

e) aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin me kohë të plotë nënshkruar nga autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë;

f) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të LAL-së;

g) aktin e pronësisë ose të marrjes me qira të objektit ku do të ushtrohet aktiviteti.

5. Dokumentacioni shqyrtohet nga MAS dhe në rast të vlerësimit pozitiv, miratohet akti i hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe/ose në nivel njësie bazë për institucionet e arsimit të lartë me seli qendrore brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e aplikimit.”

ë) Pika 3 e kreut IV/A ndryshon si vijon:

“3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, LAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit, që duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi, si dhe kodin e tij.

Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);

b) mandat pagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

c) vërtetimin e rektorit për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, që përmban listën emërore, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

ç) dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat;

d) lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;

dh) rregulloren e programit të studimit;

e) planin mësimor për çdo program studimi;

ë) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale);

f) në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe noterizuar i aktit të akreditimit të institucionit ose të programit të studimit;

g) marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimi dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, lloji i diplomës etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregulloreve të përbashkëta mësimore.”

f) Pikat 5 dhe 6 të kreut IV/A shfuqizohen.

g) Pika 3 e kreut IV/B ndryshon si vijon:

“3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, subjekti ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton riorganizimin e programit të studimit, që duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi, si dhe kodin e tij.

b) mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

c) vërtetimin nga rektori për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, që përmban listën emërore, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

ç) dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat;

d) lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;

dh) rregulloren e programit të studimit;

e) planin mësimor ekzistues dhe planin e ri të programit të studimit që riorganizohet;

ë) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale);

f) aktin e akreditimit të programit të studimit të institucionit partner të huaj i përkthyer dhe noterizuar (për programe të përbashkëta studi);

g) marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimi dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.”

gj) Shkronja “a” e pikës 1, të kreut IV/C ndryshon si vijon:

“a) LAL-ja aplikon në platformën e-Albania, për mbylljen e programit/ eve të studimit, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit të ri akademik, duke paraqitur në formularin e aplikimit shkaqet për mbylljen e programit të studimit, shoqëruar me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.

LAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit/ eve të studimit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.”

h) Pika 3 e kreut IV/E ndryshon si vijon:

“3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, LAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit;

b) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen/ riorganizimin e programit/ eve të studimit që duhet të përmbajné edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi (kur zhvillojnë lëndë deri në 30 kredite), si dhe kodin e tij. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vetë LAL-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit të LAL-së duhet të jetë e shprehur masa e financimit të plotë gjatë kohëzgjatjes së programit që do të mbulohet nga të ardhurat e LAL-së dhe nuk do të kërkohej financim shtesë nga buxheti i shtetit (për LAL-të publike);

c) aktin e miratimit të financimit të projekteve kërkimore-shkencore nga AKKSHI-ja (në rast se ka);

ç) mandat pagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin paraprak nga ekspertët e jashtëm të caktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

d) dokumentin e grupimit të njërive bazë (akt marrëveshje/ akt i organeve kolegjiale, për grupimin e departamenteve/ qendrave kërkimore-shkencore) në institucionin e arsimit të lartë, në rast grupimi sipas fushave e nënfushave, të ngjashme ose të përafërta, referuar legjislacionit në fuqi, të përcaktuara në propozimin e programit;

dh) deklarinimin për kapacitetet infrastrukturore, si vijon:

i. listën e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;

ii. listën e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune kërkimi;

iii. lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;

iv. listën e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përsbirë dhe ato elektronike;

e) deklarinimin për kapacitetet akademike, si vijon:

i. listën e personelit akademik të njësisë bazë apo grupimit të njërive sipas fushave, i kategorisë “Profesor”, me numrin e udhëbeqeje/ bashkëudhëbeqejeve në momentin e paraqitjes së aplikimit, dëshmitë e titujve akademikë dhe kontratat e punës ose vërtetimin e rektorit.

ë) rregulloren e programit të studimeve të doktoratës, e cila përfshin edhe planin e programit të studimit të doktoratës;

f) në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër të huaj të arsimit të lartë për hapjen/riorganizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe njehsuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë:

i. aktin e akreditimit të programit të studimit;

ii. marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimi dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, lloji i diplomës etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.”

i) Titulli i kreut IV/F dhe paragrafi i parë i pikës 1 të tij, ndryshojnë si vijon:

“F. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURE.”

“1. Institucionet e arsimit të lartë, aplikojnë për certifikimin e kuotave në shërbimin përkatës në e-Albania brenda datës 15 prill, kuotat për vitin akademik pasardhës për çdo program studimi, me përjashtim të numrit të udhëheqjeve për programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe ngarkojnë në sistem:

a) vendimin e Senatit Akademik;

b) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas çdo njësie bazë dhe njësisë kryesore ku atashohen;

c) informacionin mbi të dhënat për numrin e studentëve;

ç) informacionin mbi kapacitetet infrastrukturore të LAL-së, sipas tabelave të përgatitura nga ministria përgjegjëse e arsimit.

2. Për kuotat në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, për vitin akademik pasardhës, LAL-ja aplikon brenda datës 31 korrik dhe së bashku me aplikimin ngarkon dokumentacionin shoqëruar, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.”

3. Verifikimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për kuotat, lidhur me pranimet në programet e studimit për vitin akademik pasardhës, kryhet nga ministria përgjegjëse për arsimin brenda 90 ditëve nga data e aplikimit.”

j) Shkronja “c” në shtojcën nr. 1 dhe shkronja “d” në shtojcën nr. 2, shfuqizohen.

k) Fjalja e parë e shkronjës “d”, në shtojcën nr. 1, ndryshon si vijon:

“- planin mësimor për çdo program studimi që do të ofrohet, ku përcaktohet fusha përkatëse e arsimit, lëndët e ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe personeli akademik që do të angazhohet në to. Pozicionimi i programit të studimit në lidhje me programet e studimit të ofruar nga LAL-të e tjera”.

l) Shkronja “e” në shtojcën nr. 2 dhe pika 5 në shtojcën nr. 3, ndryshojnë si vijon:

“Ky seksion plotësohet për programet e përbashkët të studimit dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) burimet financiare dhe kontributin e partnerëve;

b) llojin e diplomës (e përbashkët, e dyfishtë ose e shumëfishtë);

c) të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit të huaj ose të programit të studimit të vendit të origjinës;

ç) marrëveshjen specifike për programin konkret të studimit.”

ll) Pas pikës 5/5, të kreut VI shtohen pikat 5/6 dhe 5/7 me përmbajtje si më poshtë:

“5/6. “Aplikimet për programet e përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, pranohen deri më 30 prill”.

5/7. Aplikimet dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ana Kapaj